

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA I KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRATË DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTER OF JUSTICE
Nr. Br. No: 08-422/3
Data / Datum / Date: 01/07/2022
Shtojeaj / Dodaci / Annex: -3-
PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija-
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.11/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.542/2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuje Spahija-Kerveshi, nga me autorizim bartës nga avokat , nga , si përfaqësues i palës ankues , nga fshati , komuna e , dhe Përmbaruesi Privat, me datë 22.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEȚ Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-11/2022 i datës 05.05.2022, si dhe ankesa e palës ankues , ga fshati , komuna e , datës 19.04.2022 **si i pabazuar.**

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore nⁱ nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarrë në lëndën përmbarimore P. nr. 542/2022.

A r s y e t i m

Me datën 19.04.2022,pala ankuese përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit, me pretendimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore ,pasi pala ankuesi ,asnjëherë nuk e ka pranuar urdhërin e përmbaruesit dhe propozimi për përmbarim është bërë ndaj debitori ,e jo ndaj palës ankuese, pra urdhëri është lëshuar ndaj personit juridik e jo ndaj personit fizik .Andaj, për këtë

ka parashtuar prapësim,për të cilin rast , bazuar në nenin 69 dhe nenin 70 të LPP-së,lënda do të duhej të ishte në gjykatë dhe gjykata të bie vendim bazuar në nenin 73 të LPP-së. Zyra e përmbaruesit privat nuk e ka pritur fare vendimin e gjykatës , por në kundërshim me ligjet në fuqi,vet e ka gjykuar lëndën duke bërë edhe bllokimin e llogarive bankare të palës ankuese dhe duke shkaktuar dëme dhe vështirësi për palën ankuese me tërheqjen e mjeteve nga llogaria e tij e jo sikurse ishte në propozim nga llogaria e

Nëse do të kishte urdhër ndaj palës ankuese do duhej që të dorëzohej urdhëri ndaj tij dhe që t'i jepet e drejta për prapësim.

I ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmirren masa ndaj përbëruesit privat.

Me datën 05.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në komision Raportin Përfundimtar ndaj përbartuesit privat, lidhur me veprimet përbartimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar senuk qëndrojnë pretendimet e palës ankuese , ngase përkundër faktit që në propozim shënohet s ..., numri i biznesit ka të bëjë me biznes individual. Kjo nga shkaku s ...,bazuar edhe në të dhënat në regjistrin e bizneseve dhe numrin e biznesit në atë kohë , nuk ka ekzistuar fare si person juridik, pra si SHPK,por si biznes individual,gjë që shihet edhe në nënshkrimin e debitorit garantues' ... në dokumentin përmbarimor sikur te kontrata e kredisë dhe e pengut.Këtu pala ankuese ... nënshkrues i kontratës së kredisë dhe të pengut si pronar i biznesit individual shihet se i njejti ka pasur obligim në këtë rast si person fizik.

Në seancën dëgjimore i autorizuari i palës ankuese ka deklaruar se përpos të dhënave të cekura në ankesë, prapësimi i ushtruar ndaj këtij urdhëri ka karakter suspenziv bazuar në dispozitën e nenit 74 të LPP-së. Kështu përmbaruesi përpos kësaj ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë, pretendimi i përmbaruesit se ka vepruar sipas dispozitës së nenit 48 të LPP-së, sipas palës ankuese në këtë rast nuk vlen dhe prapësimi i paraqitur brenda afatit kohor sikurse në rastin konkret, ngase do të duhej të ndërpritej përmbarimi, e i cili nuk mund të kryhet pa vendosur paraprakisht gjykata për prapësimin.

Përmbaruesi privat në seancën dëgjimore në deklarimet e cekura nga përfaqësuesi i palës ankuese ka dekluar se neni 17 i LPP-së dhe neni 167 i Ligjit pë Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore e lidhur me nenin 48 të LPP-së, e obligon përmbaruesin që pa kurrfarë njoftimi paraprak t'ë i ndërmarrë veprime sikurse edhe janë ndërmarrë në këtë rast.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së,

Këtë konstatim komisioni e bazoi në dokumentin përbartimor, kontratën e kredisë dhe pengut, ku pala ankuese është nënshkruar si person fizik, pasi edhe bazuar në numrin e biznesit pavarësisht që në propozim është shënuar s'numri i biznesit me të cilin identifiohet pala nënshkruese, i përket biznesit individual. Nënshkrimin në kote pala ankuese e ka në emër të tij si person fizik duke mos u cekur si përfaqësues i biznesit fare, por vetëm si person fizik dhe në bazë të regjistrat të pengut biznesi i tij figuron si biznes individual e jo shpk.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me karakterin suspenziv të prapësimit, komisioni për këtë pjesë i është referuar dispozitave ligjore , konkretisht nenit 47 ,pika 7 të LPP-së dhe dispozitave lidhur me ekzekutimin gjyqësor të pengut ,ku me nenin 167 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore, në pikën e parë ceket se “ Pengmarrësi i pengut , pa posedim mund të paraqesë një kërkesë në gjykatën kompetente, pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e pengdhënësit apo personave të tjerë, atë t'a autorizojë që sendin e lënë peng t'a sekuestrojë dhe t'ia dorëzojë pengmarrësit. Rreth kësaj kërkesë gjykata duhet të vendosë më së voni pesë (5) ditë pune pas datës së paraqitjes së kërkesës “.

Në pikën e dytë të këtij neni ceket se ”Pengdhënësi ose debitori i kërkesës së siguruar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente që të konstatohet se, e drejta e pengut është e pavlefshme tërësisht apo pjesërisht. Nëse gjykata vendos një konstatim të tillë, ajo duhet njëkohësisht të vendosë a do ta abrogojë apo do ta ndryshojë vendimin e nxjerrë në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni , dhe nëse vendos kësijoj, duhet të vendosë nëse pengmarrësi përgjigjet dhe në cilën shumë përgjigjet për dëmin që është shkaktuar përmes vendimit për sekuestrimin apo dorëzimin e sendit të lënë peng tek pengmarrësi.

Kjo pjesë është e rregulluar me Ligj të Veçantë dhe pala ankuese duke iu referuar nenit të njejtë, pika e dytë , do të mundet që të vërtetojë një gjë të tillë dhe të kërkoj edhe kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga organi përbirimor,nëse do të konstatohej se kërkesa e palës për dorëzim të pengut në posedim është e pavlefshme.

Pasi komisioni nuk ka pasur ndonjë provë të tillë sikurse parashihet në pikën 2 të nenit 167 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera sendore, e ka pasur të pamundur që të vlerësoj lidhur me faktin se a është ekzekutuar pengu konform dispozitave për ekzekutim gjyqësor të pengut.

Mbi bazën e të dhënavë si më lart, komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.11/2022 datë 22.05.2022



KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374, par 5 të LPP-së.